



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:095790
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05754641

PAKR.nr.171/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Krimeve të Rënda – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi - kryetar i kolegjit, Afërdita Bytyçi dhe Hashim Çollaku - anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Fitore Batatina, në çështjen penale kundër të akuzuarve Rr.H. dhe B.H. qe të dy nga fshati K., Komuna S., për shkak të veprës penale, Vrasje në tentativë nga neni 178, lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr. 63/2019, datë 26.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale, më datë 16.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr. 63/2019, datë 26.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.63/2019, datë 26.01.2024, të akuzuarit Rr.H. dhe B.H. në mbështetje të nenit 363 par. 1, nënpar. 1.3 të KPPK-së, i ka liruar nga akuza për veprën penale, Vrasje në tentativë nga neni 178, lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së. Shpenzimet e procedurës penale kanë rënë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës. Palët e dëmtuar: B.S. F.S. dhe N.S. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar t'a anulohet dhe çështjen t'a kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit Rr.H. av. V.B. me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, t'a refuzoj si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar t'a vërtetojë.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit B.H. av. H.D. me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, t'a refuzoj si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet si i ligjshëm dhe i drejtë.

Prokurori i Apelit me parashtrësën, PPA/I.nr.166/2024, datë 14.03.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa përgjigjeja në ankesë e mbrojtësit të akuzuarit B.H. av. H.D. dhe përgjigjeja në ankesë e mbrojtësit të akuzuarit B.H. av. H.D. të refuzohen të pabazuara.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, është caktuar dhe mbajtur seanca e kolegjit në të cilën prezantij i dëmtuari B.S. si dhe mbrojtësi i të akuzuarit, B.H., av. H.D., ndërsa nuk prezantuan: i dëmtuari F.S. N.S. të akuzuarit Rr.H. dhe B.H. av. V.B. si dhe nuk prezantoi as Prokurori i Prokurorisë së Apelit, edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës, andaj seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par. 4 të KPPK, në mungesë të tyre.

I dëmtuari B.S. deklarojë se e perkrah në terësi ankesën e Prokurorit të Shtetit.

Mbrojtësi i të akuzuarit, B.H. av. H.D. deklarojë se ngelet pranë përgjigjes se bërë me shkrim në ankesën e Prokurorit, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, t'a refuzoj si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar t'a vërtetoj si të ligjshëm dhe të drejtë.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, përgjigjet e mbrojtësve të akuzuarve në ankesë të PTH-së, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Pretendimet ankimore të Prokurorisë

Në ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë theksohet se aktgjykimi i ankimuar është nxjerrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse aktgjykimi i ankimuar nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 par.7 të KPPK-së, në të cilin gjykata është dashtë të paraqes qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara, e po ashtu është e obliguar që në bazë të ligjit të vlerësoj saktësinë e provave kundërthënëse dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështje penale për të cilën ka marrë aktgjykim lirues, e që në tërësi i mungojnë aktgjykimin të atakuar. Gjykata në arsyetimin e aktgjykimin nuk ka përmend provat që janë proceduar gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe nuk ka përmend krahasimin e dëshmimeve se a i beson apo jo asaj prove, arsyet me rastin e vlerësimit të provës.

Prokuroria konsideron se gjendja faktike nga gjykata shkallës së parë nuk është vërtetuar drejtë, sepse në bazë të provave të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor, rezulton se në veprimet e të akuzuarve qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën edhe janë akuzuar. Gjykata ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike kur të akuzuarit i ka liruar nga akuza ngase ka prova të mjaftueshme se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar e që kjo vërtetohet në tërësi nga deklaratat e të dëmtuarve – dëshmitarëve: B.S., F.S. dhe N.S. Më tutje në ankesë Prokurori ka cituar pjesë të deklarimit të këtyre dëshmitarëve të dëgjuar në këtë çështje penale, si dhe pjesë të deklarimit edhe të akuzuarve Rr. dhe B.H. me konstatim se nga të gjitha këto deklarata vërtetohet se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, të akuzuarit se bashku kanë tentuar ti privojnë nga jeta personat e tjerë-të dëmtuarit e

cekur në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar duke i gjuajtur me armë-pushkë automatike A-47 në drejtim të dëmtuarve në largësi prej 100-150 metra, ku të dëmtuarit kanë ikur nga ara dhe janë fshehur në mal poshtë, ndërsa plumbat janë dëgjuar duke fshikulluar një metër afër tyre. Se nga Njësia për ekspertim të armëve të zjarrit raporti i ekspertizës AKF/20141068-20140865 i (It. 16.04.2014 vërtetohet se: një fishek i kalibrit 7,62x39 mm nga dëshmia BF-D2 ishte në gjendje të rregullt, dy gëzhoja — pjesë të fishekëve të kalibrit 162x39 mm nga dëshmitë BF-DI dhe 16 gëzhoja pjesë të fishekëve të kalibrit 7,62x39 mm nga dëshmitë BF-D3 janë krahasuar mes tyre dhe është konkluduar se 18 gëzhoja — pjesë të fishekëve të kalibrit 7.62x39 nga dëshmitë DI dhe D3 janë të gjuajtura prej një arme të zjarrit të kalibrit 7.62x39 nga një pushkë automatike AK-47. Dhe në fund janë bërë krahasimet në libret e rasteve të hapura dhe nuk është gjete përputhshmëri me raste të tjera.

Lidhur me shkeljen e ligjit penal prokurori në ankesë thekson se gjykata ka shkel ligjin penal kur të akuzuarit i ka liruar nga aktakuza, për arsye se gabimisht i ka vlerësuar bazat për përjashtimin e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, pasi që ekzistojnë të gjitha provat që vërtetojnë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën edhe janë akuzuar. Në bazë të lartcekurave ka propozuar si më lartë.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat, sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilave u referohet në ankesë prokurori, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, në të nuk ka kundërthënie me vetveten e as me arsyet e tij, është i qartë dhe konkret. Aktgjykimi i kundërshtuar përmban arsyet e duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje penale. Gjithashtu kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e prokurorit se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban arsyet mbi faktet vendimtare lidhur me veprën penale, janë të pabazuara, ngase gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se prokuroria nuk ka arritur të dëshmojë se të akuzuarit Rr. dhe B.H. kanë tentuar ti privojnë nga jeta personat e tjerë – të dëmtuarit B.F. e N. S. si dhe dy nipat e tyre-fëmijët U. dhe A.D. duke gjuajtur me armë-pushkë automatike A-47 në drejtim të dëmtuarve në largësi prej 100-150 metra. Gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën

e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Pretendimet ankimore për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe gjetjet e kësaj Gjykate

Prokurori e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pretenduar se gjykata nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike pasi që nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe atë nga dëshmia e dëshmitarëve të dëgjuar në shqyrtim gjyqësor dëshmohet se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit gjen se këto pretendime ankimore të Prokurorit nuk qëndrojnë, ngase sipas shkresave të çështjes gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje sikur se pa të drejtë pretendohet në ankesën e ushtruar. Nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale, Vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, të përshkruar si në përshkrimin faktik të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

Kolegji gjen të pa bazuara pretendimet ankimore të Prokurorisë se të akuzuarit së bashku kanë tentuar ti privojnë nga jeta personat e tjerë, se të akuzuarit kanë gjuajt me armë-pushkë automatike A-47, në drejtim të dëmtuarve B., F. e N.S. si dhe dy nipat e tyre-fëmijët U. dhe A. D. në largësi prej 100-150 metra, ku të dëmtuarit kanë ikur nga ara dhe janë fshehur në mal poshtë, ndërsa plumbat janë dëgjuar duke fishkëlluar një metër afër tyre.

Gjykata shkallës së parë me të drejtë nuk u ka fal besimin dëshmive të dëshmitarëve - të dëmtuarve B.S. dhe F.S. të dhëna në shqyrtim gjyqësor, pasi që ka gjetur se këto deklarime për faktet kryesor të rastit nuk përputhen dhe se ka kundërthënie me deklaratimet e tyre të dhëna ne Prokurori dhe në Polici, për këtë çështje penale.

I dëmtuari B.S. ndryshe nga deklarami i dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, kur ka deklaruar se *”B. fillimisht ka filluar me fy, pastaj së bashku me Rr. kanë filluar me gjuajtje me kallash, ku i kanë gjuajtur diku 200 - 300 plumba në drejtim tonin”*, në deklarinimin e dhënë në Prokurori Themelore ne Mitrovice me datë 05.12.2018, për kete rrethanë ka deklaruar se *“katër persona kanë gjuajtur me kallashnikov dhe kanë qenë me maska në fytyrë”*.

I dëmtuari F.S. ndryshe nga deklarimi i dhënë në shqyrtimin gjyqësor, “*se kanë shtënë tre persona, B. ka qenë me maskë, ndërsa dy persona tjerë pa maskë, të cilët kanë qenë Rr. dhe personi tjetër nga Rrezalla*”, në deklarimin e dhënë në Prokurorin Themelore në Mitrovicë, më 05.12.2018, ka deklaruar se “*...aty kishin qenë edhe persona tjerë diku 4-5 persona, ata kanë qenë me maska...*”.

Të dëmtuarit - dëshmitaret B.S., F.S. dhe N.S. edhe në Polici kanë deklaruar se “*personat të cilët kanë gjuajtur në drejtim tyre kanë qene të maskuar*”.

Duke marr parasysh faktin se të dëmtuarit B.S., F.S. dhe N.S. menjëher pas ndodhjes së rastit, gjatë deklarimeve të tyre në polici, lirshëm kanë deklaruar se personat të cilët kanë shtënë me armë kanë qenë të maskuar. Pastaj të dëmtuarit B.S. dhe F.S. edhe në Prokurorin Themelore në Mitrovicë me rastin e marrjes në pyetje në cilësi të dëshmitarëve prapë kanë përsëritur dhe kanë deklaruar se “*personat të cilët kanë shtënë në drejtim tyre kanë qenë të maskuar*”, andaj për këtë arsye me të drejtë gjykata shkallës së parë nuk u ka fal besimin deklarimeve të tyre në shqyrtim gjyqësor, pasi që këto deklarime për faktet kryesore posaqerisht për personat të cilët kanë shtënë në drejtim të tyre me armë nuk përputhen dhe kanë kundërthënje të mëdha me deklaratimet e tyre të dhëna me herët në këtë çështje penale në Polici dhe Prokurori dhe mbeten si deklaratime të vetme të pa mbështetura në provat tjera.

Kolegji vëren se nuk ishte kontestuese se me dt.13.04.2013, në fshatin T. në vendin e quajtur “K”, ka pasur të shtëna me armë në drejtim të të dëmtuarve, pasi që kjo është vërtetuar nga dëshmitë e të dëmtuarve-dëshmitarëve: B.S., F.S. dhe N.S. dhe nga Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 13.04.2013, i Policisë së Kosovës, nga i cili vërtetohet fakti se në fshatin T., në vendin e quajtur “K”, është bërë fotografimi i vendit të ngjarjes ku janë gjetur një fishek dhe 18 gëzhoja, mirëpo nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor për arsyet e cekura me detaisht në aktgjykimin e ankimuar nuk është arritur të vërtetohet se personat të cilët kanë shtënë me armë në drejtimin e të dëmtuarve kanë qenë të akuzuarit Rr.H. dhe B.H.. Kolegji vëren se edhe nga provat materiale të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë në asnjë prej tyre nuk mund të konstatohet fajësia e të akuzuarve në raport me veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Kolegji gjen të pa bazuar pretendimin e Prokurorisë se me aktgjykimin e ankimuar është shkelur ligji penal, ngase në rastin konkret nuk janë plotësuar elementet objektive e as subjektive të veprës penale, Vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, dhe si

rrjedhojë nuk është vërtetuar as fajësia e të akuzuarve e cila nuk mund të supozohet por ajo për çdo rast konkret të veprës penale duhet të vërtetohet, nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Mbi gjendjen faktike të vërtetuar gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar edhe ligjin penal, gjithashtu aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban as shkelje tjera të cilat kjo Gjykatë konform dispozitave të nenit 394 të KPPK-së, i vëren çdo herë sipas detyrës zyrtare e të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij. Kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin e arsyeshëm, se nga provat e zbatuara nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, andaj, me të drejtë të akuzuarit janë liruar nga aktakuza.

Nga arsyet e sipërcekura, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda
PAKR.nr.171/2024, datë 16.05.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale

Kryetari i kolegjit

Fitore Batatina

Xhevdet Abazi

Anëtarët e kolegjit:

Afërdita Bytyçi

Hashim Çollaku